



## **TERMAT E REFERENCËS (ToR): Zhvillimi dhe Implementimi i Fushatës Online për Ndërgjegjësim mbi Qasjen në Drejtësi për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale në Konflikt**

### **Rreth QKRKT-së**

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1999 që ofron shërbime ndërdisiplinore në mbështetje të viktimave civile të luftës, në veçanti të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Këto shërbime përfshijnë terapi mjekësore dhe psikologjike për të mbijetuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre, ndërgjegjësim mbi të drejtat e tyre ligjore, këshilla ligjore, programe fuqizimi ekonomik, dhe aktivitete që synojnë njohjen institucionale të të drejtave të tyre. Për më tepër, QKRKT është e përfshirë në identifikimin, vlerësimin, trajtimin, referimin dhe monitorimin e të mbijetuarve të Dhunës me Bazë Gjinore (DHBGJ) midis të riatdhesuarve, personave nën moshën 18 vjeçare, si dhe refugjatëve, azil kërkuesve, persona të zhvendosur brenda vendit dhe persona në rrezik pa shtetësi.

Përveç kësaj, brenda mandatit të saj për të promovuar dhe çuar përpara respektimin e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, QKRMT-ja kryen vizita të rregullta monitorimi në vendet e mbyllura, si: burgjet dhe qelitë e paraburgimit të policisë. Gjithashtu promovon praktikën dhe standardet legislative për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të personave të privuar nga liria.

QKRMT-ja e sheh rolin e saj në shoqëri si ofrues shërbimesh psikosociale dhe ligjore, si dhe mbikëqyrës i të drejtave të njeriut. Me rëndësi të veçantë është avokimi i vazhdueshëm që QKRMT ka bërë me institucionet qeveritare në adresimin e nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, si dhe personave të privuar nga liria.

### **1. Qëllimi**

Të rritet ndërgjegjësimi publik mbi rëndësinë e qasjes në drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale në konflikt (CRSV), duke fuqizuar narrativat e të mbijetuarve dhe mesazhet e organizatave të shoqërisë civile.

### **2. Komponentët e angazhimit**

#### **2.1. Seri Rrëfimesh Digjitale (6–8 postime/video)**

Ofruesi do të:

- Zhvillojë narrativa të sigurta dhe të anonimizuara (citete, ilustrime, audio, reels tekstuale);
- Sigurojë përkthime dhe titra sipas nevojës;

- Dizajnojnë materiale të përshtatshme për Facebook dhe Instagram;
- Sigurojnë që çdo përmbajtje të kalojë rishikim etik para publikimit.

Produkti final:

- 6–8 postime ose video të gatshme për publikim.

## **2.2. Video mbi ndikimin në qasjen në drejtësi**

Ofruesi do të:

- Zhvillojë skenarin në bashkëpunim me Porositësin;
- Kryejë rishikim etik dhe miratim;
- Realizojë editim të thjeshtë me materiale ekzistuese ose ilustrime;
- Shtojë titra dhe elemente të aksesueshmërisë.

Produkti final:

- 1 video.

## **2.3. Promovim i targetuar në rrjete sociale**

Ofruesi do të:

- Hartojë plan të promovimit të paguar;
- Targetojë të rinjtë, edukatorët, gazetarët dhe audiencat me interes në politika publike;
- Monitorojë performancën e postimeve.

Produkti final:

- Raport analitik mbi reach, engagement dhe audience insights.

## **3. Kohëzgjatja**

Angazhimi pritët të zgjasë nga 02.12.2025 deri më 30.04.2026.

Ofertat duhet dërguar jo më vonë se 29.11.2025 në [info@krct.org](mailto:info@krct.org)

## **4. Kualifikimet e kërkuara**

- Përvojë në komunikim publik dhe menaxhim të fushatave digjitale;
- Njohuri mbi qasjen trauma-informed dhe etikën në punë me të mbijetuar;
- Përvojë në prodhim video dhe editim;
- Aftësi për promovim të paguar në rrjete sociale.